

DEKRET
Nr. 12031, datë 19.3.2021

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe të nenit 136 të Kushtetutës; të nenit 48, pika 11, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 17.3.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë, me shkresën me nr. 1135/14 prot., datë 16.3.2021, dhe të vendimit nr. 89, datë 12.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit znj. Albana Boksi”, shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 242, datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Albana Boksi emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta